

URDHËR
Nr. 219, datë 16.7.2021

**PËR MBYLLJEN E DEGËS “EPITECH ALBANIA”, SI NJËSI BAZË E
INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË TË HUAJ “ECOLE POUR
L’INFORMATIQUE ET LES NOUVELLE TECHNOLOGIES (EPITECH)”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 7, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; germave “a” dhe “ç”, nënpika “i”, të pikës 6, të vendimit nr. 418, datë 10.5.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e degës “Epitech Albania”, si njësi bazë “Ekspert i Teknologjisë së Informacionit”, i njësisë kryesore “Ekspert i Teknologjisë së Informacionit” të institucionit të arsimit të lartë të huaj “Ecole pour l’Informatique et les Nouvelle Technologies (EPITECH)” dhe ndërprerjen e veprimtarisë së saj akademike.

2. Personi juridik, qendra “Epitech Albania”, regjistruar me vendimin nr. 1101, datë 9.5.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, “Për regjistrimin si person juridik”, ka këto detyrime:

a) të mbyllë të gjitha detyrimet lidhur me veprimtarinë akademike për vitin akademik 2020–2021, në të dy programet e studimit të ofruara prej saj “Bachelor”, në “Teknologji Informacioni” dhe “Master i Shkencave” në “Ekspert i Teknologjisë së informacionit”;

b) të përgatitë dosjen për çdo student të pa diplomuar, me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit të lartë për vazhdimin e studimeve dhe t’ia vendosë atë në dispozicion vetë studentit, pa asnjë detyrim financiar shtesë nga ana e tij, brenda datës 31 gusht 2021;

d) të vendosë në dispozicion të ministrisë përgjegjëse për arsimin çdo informacion të kërkuar dhe të vazhdojnë të mbajnë kontakte me MASR-në, deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë urdhër;

e) të kthejë pagesat e kryera nga studentët për pjesën e papërfunduar të programeve përkatëse të studimit, për rastet kur pagesat janë kryer, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbytur që mund të ketë ndaj studentëve.

3. Personi juridik, qendra “Epitech Albania”, nuk duhet të kryejë asnjë lloj veprimi financiar apo lëvizje në llogaritë bankare, përveç atyre që kanë lidhje me sa parashikohet në shkronjën “e”, të pikës 2, të këtij urdhri. Personi juridik privat, që përfaqëson degën “Epitech Albania”, nuk mund të kryejë asnjë lloj ndryshimi të aksioneve apo kuotave të qendrës, aseteve të luajtshme e të paluajtshme të saj, para shlyerjes së detyrimeve të parashikuara në këtë urdhër.

4. Të gjitha shpenzimet për likuidimin e studentëve dhe kryerjen e procedurave për ta, në zbatim të këtij urdhri, të përballohen nga personi juridik, qendra “Epitech Albania”.

5. Personi juridik, qendra “Epitech Albania”, duhet të marrë masa që të ketë në dispozicion staf administrativ dhe personel akademik të nevojshëm deri në mbylljen dhe përfundimin e procesit, sipas afateve të përcaktuara në këtë urdhër.

6. Personi juridik, qendra “Epitech Albania”, të arkivojë menjëherë të gjithë dokumentacionin ligjor të degës “Epitech Albania”, sipas ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”.

7. Për personin juridik privat, qendra “Epitech Albania”, administrator i degës “Epitech Albania”, mund të aplikohen masa të tjera, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në rast të moszbatimit të këtij urdhri.

8. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar dhe personi juridik qendra “Epitech Albania”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Evis Kushi